

SHQIPËRIA E RE

Përmbledhje Ekzekutive

36 vjet pas rrëzimit të sistemit komunist Shqipëria mbetet në tranzicion. Fasadat me ngjyra dhe me xham nuk fshehin dot më mungesën përmbajtësore dhe mungesën e transformimit të vërtetë drejt një shteti demokratik me ekonomi tregu të lirë që respekton mjedisin dhe kulturën e vendit.

Fallsiteti 36-vjeçar u gris përpara syve të gjithë botës kur një rojë private goditi dhe bashkë me shokët e tij tërhosoi zvarrë për qindra metra një qytetar që protestonte për të drejtën e pronës private dhe aksesit publik në plazh. E gjitha kjo ndodhi në sy të Policisë së Shtetit e cila u sulmua me spraj me piper njëlloj si edhe qytetarët.

Kupa u mbush, u rëzua dhe tani është në shesh prej më shumë se një muaji. Shqiptarët janë bashkuar në gjerësi dhe thellësi të paimagjinueshme dhe të pa-precedente jo vetëm për Shqipërinë. Atyre u janë bashkuar edhe turistë, opinioni botëror mediatik dhe qytetarë nga e gjithë bota duke frymëzuar anekënd saj për mbrojtjen e të drejtave të tyre, sundimit të ligjit, të pronës private, të mirës publike dhe mjedisit.

Përballë tyre qëndron një "lider" si Kryeministri Rama i cili shikon fasadën e ngritur me kujdes t'i shkërmoqet para syve. I tmerruar nga ky bashkim i shqiptarëve po sulmon me metodat e njohura të linçimit personal, metodave të Sigurimit të Shtetit dhe teknikave të zakonshme të manipulimit. Nje sistem që ka kontraktuar Cambridge Analytica për shërbime zgjedhore, që patronazhon në nivel shtetëror të cilin do ta plotësojë me sisteme të akuzuara me ngjashme me survejimin masiv dhe të renditjes shoqërore ankohet edhe për mjetet moderne të manipulimit publik dhe algoritmet. Me siguri që dhemb kur shikon të njëjtat teknika të shfrytëzimit të rrjeteve sociale që ke përdorur për të sunduar tanimë të përdoren nga këta "rebelë armiqësorë me kauza të vërteta" si ata që themeluan Amerikën.

Përallat dhe premtimet e tua me miliarda që do të vijnë përplasen dhe shkërmoqen përpara fakteve. Dhjetëra ministra e zyrtarë të dënuar apo akuzuar për korrupsion. Dhënia falas e Portit më të madh tregtar të Durrësit për "investim strategjik" prej 2 miliardë eurosh që në fakt ka shpenzuar vetëm 8 milionë euro kapital të vet. Mashtrimi i Madh 83 mandate për Shqipërinë në BE në 2030 thërrmohet përpara faktit se janë kryer vetëm 23% të reformave të Planit të Rritjes të Bashkimit Evropian për të cilat BE paguan ~1 miliard euro. Mund të imagjinohet lehtë çfarë performance ke në zbatimin e reformave për të cilat nuk paguhesh sepse nuk ke asnjë plan që Shqipëria të anëtarësohet në BE! Të paktën jo si një Shqipëri e transformuar si e gjithë Evropa. Për këtë qëllim prej vitesh hedh teza për "urgjencë strategjike" dhe pranim me të drejta gjysmake.

Paketa e ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore që ju paraqesim është zëri i shqiptarëve në shesh në Tiranë prej më shumë se një muaji dhe po ashtu në qytete të tjera të Shqipërisë dhe të mërgatës nga Australia në Kanada. Është një paketë e plotë transformuese për një Shqipëri të Re që mbron pronën private dhe publike, ambientin, trashëgiminë kulturore, kthen demokracinë e drejtpërdrejtë tek individ, tek familja, tek të pafuqishmit dhe tek ata ndryshe, si dhe për afron çështje moderne tashme në diskutim në Bashkimin Evropian.

Një listë me mijëra shqiptarë të përgatitur, patriotë dhe me dinjitet është gati për të zëvendësuar çdo burokrat të korruptuar që nuk po kryen dhe po pengon transformimin e vërtetë të Shqipërisë së Re si vend anëtar i denjë i BE dhe jo një kalë Troje, barrë demokratike dhe ekonomike për të. Politika e Vjetër t'i votojë pa vonesë. Metodatat tona demokratike kanë fuqi dhe aftësi që nuk i keni parë dhe që nuk mund t'i imagjini.